# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-452286**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Studentët marshojnë në Prishtinë kundër Speciales: Drejtësi për heronjtë tanë – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/studentet-marshojne-ne-prishtine-kunder-speciales-drejtesi-per-heronjte-tane/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 12:41:57 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 12:36:46 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d5b6f9b7519c6445d1806556e470b7f3879e985ca92d6aba187162e5e9fcae82` |
| TEKSTI | `9dbcfc70da916b09d6ac7cd781e870fe2cabe2f2171d0d6e8c2984ab179c1319` |
| PAMJA | `82236b1b1624375bc8090f3a78f940ded494c6c071477c5171ba84123f800640` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `73af8c637b2c9b98e3187ead18b9a4036141aa0c4523adeb5489065d9cf2964d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/73af8c637b2c9b98e3187ead18b9a4036141aa0c4523adeb5489065d9cf2964d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

burgim nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë.

Marshimi nisi nga Biblioteka Kombëtare dhe vijoi drejt sheshit “Skënderbeu”, për të përfunduar para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës. Studentët e cilësuan vendimin e gjykatës si të rëndë dhe të padrejtë për Kosovën dhe shqiptarët.

Me flamuj kombëtarë dhe pankarta në duar, protestuesit mbanin mesazhe si “Jo në emër të studentëve”, “Studentët kërkojnë drejtësi” dhe “Liri dhe drejtësi për heronjtë tanë”.

Gjatë marshimit, ata brohoritën në mbështetje të UÇK-së dhe përmendën emrat e katër ish-krerëve të saj, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Në disa momente, protestuesit edhe kënduan, ndërsa gjatë rrugës marshimit iu bashkuan edhe qytetarë të tjerë.

Përfaqësuesi i studentëve, Ilir Cani, e cilësoi vendimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së si të padrejtë dhe pretendoi se ai është ndikuar politikisht.

“Sot jemi mbledhur këtu për të protestuar ndaj këtij vendimi të padrejtë që iu bë çlirimtarëve tanë. Edhe ata ishin njëherë studentë që u çuan në protesta kundër padrejtësive. Sot ua ndjejmë borxh që të ngrihemi në protestë për ta”, tha Cani.

Ai deklaroi se studentët do të vijojnë protestat nëse, sipas tij, nuk ka ndryshim të vendimit.

“Liri çlirimtarëve! Rroftë UÇK-ja, rroftë kombi shqiptar. Ne mendojmë se ai

pas 25 vitesh nuk jemi gati ta...

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

vendim është marrë me influencë politike, nuk ka të bëjë diçka me drejtësinë. Serbia ishte agresori dhe krimineli i vërtetë, jo UÇK-ja", u shpreh ai.

Cani paralajmëroi protesta më të mëdha, duke e cilësuar marshimin e sotëm  vetëm fillimin e angazhimit studentor. Sipas tij, në protestë morën pjesë studentë nga universitetet publike dhe private.

Në mesin e qytetarëve që iu bashkuan marshimit ishte edhe ish-luftëtari i UÇK-së, Binak Gashi. Ai vlerësoi se lufta e UÇK-së ishte e drejtë dhe u bëri thirrje studentëve të vijojnë angazhimin e tyre.

"Lufta jonë ka qenë e drejtë edhe e pastër. Ju falënderoj për vullnetin e madh që keni për lirinë e tyre. Së bashku nuk do të ndalemi deri në fund", tha Gashi.

Ai kërkoi gjithashtu ngritjen e komisioneve për shqyrtimin e vendimit të Dhomave të Specializuara, duke pretenduar se dëshmitë kundër ish-krerëve të UÇK-së janë dhënë nën ndikimin e Serbisë. Këto janë pretendime të tij.

Gashi theksoi edhe një herë rolin e studentëve në protestat ndër vite në Kosovë, ndërsa tha se veteranët e UÇK-së janë të gatshëm të vazhdojnë mbështetjen për ta.

"Gjithmonë, edhe në kohën më të vështirë, studentët kanë luajtur rolin kyç!", deklaroi ai.

Sipas Gashit, e ardhmja e Kosovës është në duart e të rinjve dhe studentëve.

#marshim #Prishtine #studente

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



KOSOVA
**"Beteja nuk ka mbaruar", djali i...**
Xhuljana Zhuleku · Sot 00:11



KOSOVA
**"Liria ka emër"/ Rita Ora dhe Dua Lipa në...**
Xhuljana Zhuleku · Dje 23:29



KOSOVA
**Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK-së,...**
Xhuljana Zhuleku · Dje 22:38

## Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri * E-mail *




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.